



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Zyra e Kryeministrit –Ured Premijera –Office of the Prime Minister

Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistiku Kosova - Kosovo Agency of Statistics

Duke u bazuar ne Ligjin Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civilë te Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2010 Procedurat e Rekrutimit ne Shërbimin Civil te Republikës se Kosovës , *Agjencia e Statistikave të Kosovës* shpallë:

KONKURS

1. Zyra e Kryeshefit Ekzekutiv , një (1) pozitë te karrierës:

Titulli: Një (1) Asistente Ekzekutive

Numri i referencës : ASK-ZKE-005

Koeficienti :7

Detyrat dhe përgjegjësit :

- Bashkërendon dhe udhëheq me efikasitet zyren e Kryeshefit Ekzekutiv,
- Menaxhon tërë kuminikimin me telefon dhe faks per Kryeshefin Ekzekutiv duke siguruar qe te gjitha thirrjet te shqyrtohen dhe te trajtohen ne pajtim ne protokolin e vendosur me parë,
- Sipas nevojës përpilon shkresa /memorandumet per Kryeshefin Ekzekutiv,
- Organizon takime , perkujton Kryeshefin Ekzekutiv per takimet dhe merr shenime gjatë takimeve ,
- Pranon , rregullon dhe i ruan publikimet dhe materialet tjera drejtuar Kryeshefit Ekzekutiv ,
- Sipas nevojës kryen interpretime dhe bënë përkthime ,
- Per punët dhe detyrat e kryera i përgjigjet Kryeshefit Ekzekutiv

Kualifikimi arsimor: Shkollimi bachellor

-Pervoja :Se paku 4 vite pervojë pune ne fushen relevante .

Kompetenca dhe aftësitë:

- Njohuri ne te gjitha aspektet e ofrimit te sherbimeve dhe koordinimit si dhe aftesi ne punet administrative –teknike.
- Aftësi pune me kompjuter (Word ,Excel)
- Njohja e gjuhes angleze,

- Shkathësi të mira të komunikimit , përfshirë aftësinë për të interpretuar informata, dhënë udhëzime dhe përcjellë informata tek të tjerët;
- Azhur dhe i gatshëm ne kryerjen e detyrave te punës.

Procedura e konkurimit:

Ne Shërbimin Civilë kane te drejte te punësohen shtetasit e Republikës se Kosovës te moshës madhore ,te cilët kane zotësi te plote për te vepruar,përgatitje te nevojshme arsimore dhe aftësi profesionale për zbatimin funksionit administrativ dhe te cilët kane aftësi fizike qe kërkohen për pozitën përkatëse.

Aktet ligjore dhe nënligjore qe e rregullojnë rekrutimin:

Përzgjedhja e Shërbyesve Civilë behet ne pajtim me Ligjin –Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civilë te Republikës se Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e rekrutimit ne Shërbimin Civilë.

Kohëzgjatja e emërimit:Sipas Ligjit te Shërbimit Civil te Republikes se Kosoves , ne te cilën është përfshirë periudha e punës provuese prej një (1) viti.

Konkursi është i hapur 15 dite kalendarik nga dita e publikimit ne mjetet e informimit publik.

Marrja dhe dorëzimi i aplikacioneve:

Aplikacionet merren dhe dorëzohen në Agjencionin e Statistikave te Kosovës,Rr, "Zenel Salihu" nr.4 Prishtinë. Aplikacionit i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin, përvojën ,vertetimin nga Gjykata qe personi nuk eshte nene hetime dhe dokumentacionet e tjera të nevojshme, që kërkohen për vendin e punës për të cilin konkurroni.

Kërkesat e derguara pas dates se fundit nuk do te pranohen.Kërkesat e pakompletuara do te refuzohen.

Për shkak të numrit të madh të kërkesave të pranuar , vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.

Kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do ti nënshtrohen testimit me shkrim dhe intervistimit.

Për informata të hollësishme, mund të kontaktoni me zyrën e personelit , në tel: 038- 20031149 , prej orës 08:00 – 16: 00.

“Shërbimi Civilë i Kosovës ofron mundësi te barabarta te punësimit per te gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga te gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga te gjitha komunitetet ne Kosovë.

“Komuniteti jo - shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike qendrore dhe lokale, siç specifikohet në Nenin11, paragrafin 3 të Ligjit Nr. 03/L-149 mbi Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës”.

